



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.108/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K. Sh.A., me seli në P., rr. "...." nr., kundër debitorëve 1. NTP "B. C." me seli në V., rr. "...." nr.,, 2. F. M. me adresë në rr. "...." nr.,, V., si dhe 3. M. F. me adresë në rr. "....", p.n, V., me bazë juridike borxh në bazë të titullit ekzekutiv, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.02.2024, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë– Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 66,001.48 €. me aktvendimin E.nr. 55/2006, të datës 30.01.2006. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktvendimin CP.nr. 115/2014, të datës 20.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale , Dhomave të Shkallës së Parë departamentit për Çështje ekonomike.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e vet, KPPP.nr. 2103/23, të datës 09.02.2024 ka hapur konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me asnjërin nga mjetet juridike të parapara në kompetencë të Gjykatës Komerciale por kemi të bëjmë me

përmbarrimin e dokumentit në lejin e të cilit janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e lejuara,, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri.

Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi vlerësimin ligjor se kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: "Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2.: të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate."

Me qenë se nuk kemi të bëjmë me mjetet juridike në procedure përmbarrimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbarrimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: "Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa," ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen se mjetet e jashtëzakonshme nuk lejohen përveç kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në raste të parapara me ligj, duke u nisur nga fakti se në rastin konkret, lënda ka për objekt zbatimin e përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarrimore Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarrimore.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbarrimore është Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, për faktin se palët në këtë çështje përmbarrimore pasi që është lejuar përmbarrimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejin e përmbarrimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përmbarruesi privat ashtu siç është përcaktuar

me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përmbarimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përmbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përmbarimore, atëherë kjo çështje përmbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Andaj, duke u bazuar në nenin 5 pika 5 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim është Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtrri. Për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Vushtrri.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

CN.nr.108/2024 datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami